



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 341, datë 09.07.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR
POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA
ME VENDIMET NR. 245 DHE NR. 246 DATË 02.05.2024, TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR
KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 9, të Vendimit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z. Markelian Koça,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësishtimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionete lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR